

Gjykata komunale për kundërvajtje në Ferizaj ,në procedurën kundërvajtëse kundër Ramadan Hasanit nga Ferizaji për shkak të veprës nga neni 16.1.1 të Ligjit për Deklarimin, e Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë dhe të Dhuratave të Zyrtarve të lartë Publik, dhe duke u bazuar në nenet 31,73 dhe 195 të Ligjit për kundërvajtjet me datë 26.09.2011 merr:

AKTVENDIM

I pandehuri Ramadan Mehmet Hasani i lindur më 07.06.1953 nga Ferizaji rruga Zenun Beqa nr. 17.

është përgjegjës,

Sepse si zyrtarë i lartë publike brenda afatit të lejuar ligjor përkatësisht deri me 31.03.2011 nuk ka deklaruar deklarimin e rregullt vjetor të pasurisë te Agjencia kundër Korrupsionit dhe kontrollin e pasurisë dhe të dhuratave të zyrtarve të lartë publik..

-andaj në bazë të dispozitës së cekur ligjore.

DENOHET

ME GJOBË në shumë prej 300 €.

Dënimin e shqipëtuat duhet ta paguaj në afat prej 15 ditësh, nga dita e plotëfudhmerisë së këtij aktvendimi. Nëse të njëjtin nuk e paguan në afatin e caktuar, do të zëvendësohet me dënim burgu në kohëzgjatje prej 20 ditësh.

Në emer të shpenzimeve procedurale obligohet që të paguaj shumën paushalle prej 5 €, në afatin e njejtë sikur edhe dënimin në të holla.

Nga një ekzemplar i këtij aktvendimi u dërgohet palëve.

Arsyetimi

Agjencia kundër korrupsionit në Prishtinë ,kësaj Gjykater i parashtrori kërkesën nr.01-3210/2011 të datës 14.07.2011 për fillimin e procedurës kundërvajtëse kundër të pandehurit ,për shkak të kundërvajtjeve të përshkruara si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Gjyqtarja filloi procedurën kundërvajtëse mori në pyetje të pandehurin i cili në deklaraten e tij ka theksuar se është e vërtet që kam pranuar formularin per deklarimin e rregullt vjetor të pasurisë së zyrtarve të lartë nga agjencioni kundër korrupsionit por te njëjtin nuk e kam plotësuar në afatin e përcaktuar ligjor per shkak se ne momentin e pranimit të formularit kamë pasur një vendim të Ministris së pushtetit lokal se zgjedhja ime si zëvendës kryesues ka qenë e kundërligjshme dhe per kete më është ndërprerë edhe paga si zëvendës kryesues , per këtë gjykatës i ka prezantuar një njohtim që i është bërë Kuvendit Komunal te Ferizajit nga Ministria e administrimit të pushtetit lokal ne Prishtine te dates 18.01.2010 dhe një vërtetim nga Kuvendi Komunal i Ferizajit, me të cilin vërtetohet se i pandehuri nga data 28.01.2009 e gjer me 31.05.2010 ka qenë Zëvendës kryesues i Kuvendit komunal ne Ferizaj , ndërsa nga data 01.06.2010 ka qenë vetem si anëtarë i Kuvendit komunal në Ferizaj.

Duke u bazuar në kërkesen per fillimin e procedures kundërvajtëse deklaraten e të pandehurit në njoftimin e Ministris së administrates të pushtetit lokal ne Prishtinë të datës 18.01.2010 dhe në vërtetimin e kuvendit komunal te datës 20.09.2011 Gjyqtarja konstatoi se i pandehuri nga data 28.01.2009 e deri më daten 31.05.2011 ka qenë Zëvendës kryesues i Kuvendit Komunal ne Ferizaj , dhe per kete ne baze te ligjit ka qenë i obliguar qe te beje deklarimin e pasurisë se tij tek organi kompetent gjegjësisht ne agjencioni kunder korrupsionit ne Prishtinë.

Në bazë të kërkesës për fillimin e procedures kundërvajtëse deklarates së të pandehures si edhe shkresave tjera të lëndës gjyqtari vleron se i pandehuri ka kryer kundërvajtje nga neni 16.1.1 të Ligji për deklarimin prejardhjen dhe kontrollin e pasurisë dhe të dhuratave të zyrtarve të lartë publik,për çka u shpall përgjegjëse dhe u dënua si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Gjatë matjes së dënimit është marrë parasysh pesha e kundërvajtjes dhe pasojat e sajë, rrethanat nën të cilat është kryer kundërvajtja, gjendja ekonomike e të pandehurit andaj iu shqipëtuat një dënim i këtillë me bindje se edhe me këtë lloj dënimi do të arrihet qëllimi ndëshkimor.

Këshilla juridike:

Kundër këtij aktvendimi mund të ushtrohet ankesë Gjykatës së lartë për kundërvajtje në Prishtinë, brenda afatit prej 8 ditësh, nga dita e pranimit të këtij aktvendimi, përmes kësaj Gjykate pa pagesë takse.

Vendosur në Gjykatën komunale për kundërvajtje në Ferizaj, më 26.09.2011.

Sek. Juridike
Imrane Shabani



Gjyqtarja
Hysrije Gashi